

8 janar 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.23/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e riparimit nga KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Derek Wilson si lojtar i huaj.

II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, dhe duke u bazuar në udhëzimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit si shkallë e dytë e vendimmarrjes, sipas Vendimit të tyre të datës 08.01.2026, në bazë të Nenit 13.16 të Propozicioneve të Garave, lejohet regjistrimi i lojtarit Derek Wilson për KB Vëllaznimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.23/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

(a) Komisioni i Garave i FBK-së ka shqyrtuar kërkesën e KB Vëllaznimi, i cili, në bazë të Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të datës 08.01.2026, ka riparaqitur kërkesën për regjistrimin e lojtarit Derek Wilson si lojtar i huaj.


(b) Komisioni i Garave, duke vlerësuar udhëzimet e dhëna nga Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit si shkallë e dytë e vendimmarrjes në Vendimin e tyre të datës 08.01.2026, dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 13.16 të Propozicioneve të Garave të FBK-së për sezonin 2025/2026, vlerëson se kërkesa e KB Vëllaznimi është e bazuar dhe në përputhje me aktet normative në fuqi dhe, si e tillë, miratohet, duke lejuar regjistrimin e lojtarit Derek Wilson për klubin KB Vëllaznimi me të drejtë loje të menjëhershme.

(c) Udhëzohet personi përgjegjës në FBK që të procedojë me regjistrimin e lojtarit Derek Wilson për klubin KB Vëllaznimi, me të drejtë loje të menjëhershme, në përputhje me rregulloret në fuqi të FBK-së.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.